

GJUHA ALEGORIKE E “TË FSHEHURIT”

1.

Në gjuhën shqipe, të dy dialektet ngërthejnë në vetvete një pasuri të madhe leksikore. Në dialektin e Veriut, bën pjesë edhe e folura e Dibrës. Pa marrë në hulumtim problemet e tjera, këtu do të ndalemi në grupet e të folurit me nënkuptime ose me fshehje të mendimit. Kjo mënyrë të shprehuri përbëhet nga njësi më të vogla, në të cilat gëlojnë edhe mjaft fjalë të krahinës përkatëse, karakteristikë e disa zonave të veçanta. Kjo e bën atë një gjuhë të veçantë, që më shpesh është quajtur të folurit alegorik, duke marrë kështu dhe disa emërtime të tjera, që përdoren rëndom në sociolinguistikë, si: të folurit “me rrotulla”, “me mesele” apo të folurit “me shifër”, sikurse i thonë më tepër në Dibër etj. Vetë alegoria në koncept përmban në thelb kuptimin e nënkuptuar, i cili, kryesisht, ka të bëjë me kuptimin “e fshehur”.

Gjuha alegorike, pra, përmban “të fshehur” kuptimin e mendimit që përcjell. Ajo ka një hapësirë gjeografike, një truall ku kultivohet, duke formuar një areal të qenësishëm, mbase unikal, nëpërmjet transmetimit që ky të folur mbart në vetvete. Duhet kuptuar e vlerësuar faktorët gjuhësorë, me kombinimet e tyre sintaksore e leksikore, se ato janë majaja e lëndës që përdoret gjatë të folurit alegorik.

Kjo e folur, sot për sot, duke u parë si një dukuri e etnicitetit i pastër shqiptar, është, gjithashtu, dhe shprehje etnolinguistike, me shtrirje gjeografike të ndryshme në zonat e trevave shqiptare. Gjuha alegorike, ndonëse përdoret dendur në disa fshatra të Kosovës ose në trevën e Dibrës, duke qenë unike në llojin e vet, është edhe tipike vetëm për atë hapësirë gjeografike e shoqërore. Duhet marrë parasysh se brenda një nëndialekti gjenden këto perla që, si shprehje të bilinguizmit dialektor, paraqesin vlera të padiskutueshme. Ndonëse me variacione të shumta, ato paraqesin një kulturë materiale dhe shpirtërore të lidhur

pazgjidhshmërisht midis tyre. Edhe materiali, me të cilin ata gatujnë këtë të folur, nuk përmban fjalë të huaja dhe mbështetet në të folurin nëndialektor, në njësi të vogla, pikërisht tipike për atë zonë apo krahinë.

Nënteksti i shprehur me këtë mënyrë të foluri është i ndërvarur nga rrethanat e komunikimit, ai lidhet me gjykimet dhe vlerësimet përkatëse si dhe me mendimet popullore që, tërthorazi, përmes frazeologjish e shprehjesh të shkurtra, transmetojnë një mesazh, një ide, përçojnë një zgjidhje. Të folurit me nënkuptime ka në themel thënie të moçme apo tregim të sajuar aty për aty, madje, mbase, edhe ndonjë anekdotë të transformuar, duke mbartur në vetvete edhe një lloj të shprehjes artistike.

Ashtu sikurse e ka theksuar me të drejtë studiuesi i njohur Gjovalin Shkurtaj: "Antropologët, në dallim nga gjuhëtarët, nuk e kanë konceptuar kurrë të folurit të shkëputur nga jeta shoqërore, por kanë ngulmuar rreth ndërvarësisë së tij me strukturat shoqërore e kulturore... Antropologët studiojnë tema të lidhura ngushtë edhe me gjuhën, si lidhja midis vizionit të botës, kategorive gramatikore dhe fushave semantike; ndikimi i përdorimit të gjuhës mbi shoqërizimin dhe lidhjet ndërpersonale; ndërveprimi midis bashkësisë gjuhësore dhe bashkësisë shoqërore"¹. Në gjuhën alegorike kemi një lloj të foluri që kultivohet nga pjesëtarë të bashkësisë shoqërore, dhe paraqitet me mjete të fuqishme shprehjeje. Madje, përdorimi i këtyre mjeteve, bën të mundur të kuptohet thelbi apo kuptimi kyç i mendimit të fshehur në të.

Studimet sociolinguistike nga njëra anë na japin informacione bazë dhe të dhëna shoqërore, ekonomike e politike dhe, nga ana tjetër, paraqesin një dimension të përgjithshëm të zhvillimit dhe evoluimit të gjuhës (me anë të informacioneve, të dhënave, analizave etj.), në përqasje me njohjen e shoqërisë, të pasurimit të mjeteve shprehëse gjuhësore duke i lejuar asaj edhe mundësinë e depërtimit në folklor, letërsi dhe artet, si shprehje të shpirtit të një kombi. Këto studime janë burime të pashtershme në përhapjen e përvetësimin e vlerave qytetëruese, kur dihet se këto dije janë të lidhura me mbarë shoqërinë. Në këtë ndërveprim, gjuha fiton vlerat e veta reale, se tashmë ajo është

e pykëzuar në udhën e mbarë: të studiojë rrjedhën e dukurive dhe ardhmërinë e tyre, me qëllimin e lartë që të bëhen pjesë e jetës dhe t'i shërbejnë veprimtarisë njerëzore. Në këtë kontekst, duhet kuptuar qartësia dhe saktësia e shumëvlershme e gjuhës së të fshehurit, pavarësisht se si lidhen e bëhen zhvillimet e ndryshimet hapësinore gjeografike. Kjo është edhe një nga arsyet që studiuesit nënvizojnë me të drejtë se të folurit me nënkuptime është i përhapur më shumë në Kosovë, në Dibër dhe në disa vatra të vogla të Shqipërisë Verilindore.

*

* *

Të folurit alegorik në Dibër është një veçori e nëndialektit lokal, një stil i veçantë, i figurshëm i gjuhës popullore. Baza e këtij të foluri specifik janë të ashtuquajturat "mesele", tregime alegorike ose të sajuara, që, pas paraqitjes së drejtpërdrejtë, fshehin kuptimin domethënës.

Në trevën e Dibrës ky i folur është më i zhvilluar në Dibrën e Poshtme, në krahasim me Dibrën e Epërme. Në fshatrat e Dibrës së Poshtme ajo është zhvilluar në Malësi, ku edhe kushtet natyrore i kanë detyruar banorët ta përdorin midis tyre këtë lloj të foluri. Janë të njëjtat kushte që përmenden edhe për Drenicën, si: mungesa e komunikacionit në pjesët e brendshme, arsimimi i ulët, gjendja e vështirë ekonomike etj., "të gjitha këto arsye e kanë lënë Drenicën në një errësi dhe mbrapambeturi të plotë, të mbyllur në një rreth pak a shumë të kufizuar, ku kanë mbretëruar marrëdhënie shoqërore të rendit fisnor feudal, si dhe botëkuptimet, bindjet dhe normat morale e kanunore të familjes patriarkale".²

Në disa zona të Dibrës, si: në Luzni (Katundi i Ri, Lishan i Epërm, Lishan i Poshtëm, Arapaj i Epërm, Arapaj i Poshtëm, Hotes), Kishavec, Gjoricë, Reç, Dardhë, Muhur, Grykë e Vogël etj., etj. ka qenë dhe ende vazhdon të zhvillohet alegoria, e cila ishte rrjedhojë e zgjuarsisë natyrale të dibranëve.

Në zona të tjera të Dibrës ka pasur përpjekje për të gjetur zanafillën e kësaj të folure, por një lloj historiku gjejmë edhe në këto fjalë të një malësori: "Ene pse ishin në këto vala (në luftë kundër pushtuesve -AN), shqiptarëve di xhaja (dy gjëra) nuk ka mundë me ua nal kush: gjojën (gojën, këtu; fjalën) e tij ene

(edhe) pushkën që mate (mbante) në dorë, ditë e natë. Por, që të mos pushojte gjoja e dajlanes (lloj pushke), duhet përfun llafi... Çish atëhere (Që atëherë), thonë se nisi nëpër oda e kuvene muhabeti me mesele "bjeri shqemës (pragut) të nigjojë dera". Herën e parë, kallzojshin të vjetrit, ki soj llafi ka lie (lindur) prej pak njerëzish. Atine ua kish kërkue nevoja, halli me u marrë vesh domosdo me njani-qetrin, me një "dekik" të vështirë, për me dalë prej rrezikut. Fillimisht ia filluen me meseletë e shkurtua e ma vonë kanë ardhë tue ftollue menen (mendjen) e tue i zgjatun ene meselet. Po se kush i ka zanë fajll (fill), kët nuk mund ta xhejmë me emna, se ka kushedi sa breza. Veç unë thom se kallzimit të çeqve (pleqve) duhet me u shtaj shpajrt (fatur shpirt, duke i pranuar si të vërteta), se na e bajmë provë ene sot. Kur jemi në një valle burrash e bahet llafi me mesele, sa herë zihemi ngushtë më noj llaf e nuk kujtojmë noj mesele qi kemi nigjue me ja përshtatun përgjigjes që duhet dhanë, aty për aty rrekemi të sajojmë vetë një ngjarje që i përshtatet muhabetit".³

Ka të tjerë tregues të të folurit me shifër që japin, gati me saktësi e siguri, se ku ka lindur ky i folur në Dibër të Poshtme. Sipas përdoruesve të të folurit me mesele, në Dibër, vendi ku janë "shpikur" fjalët me shifër, pra të folurit e fshehur, është Mazhica, një fshat i vogël, me nja 30 shtëpi. Kur udhëton për në Peshkopi, fshati gjendet në të majtë të rrugës që kalon midis Shupenzës, atje midis maleve. Mazhica kufizohet me disa fshatra të tjera të vogla, si nga veriu me Shtushaj, nga lindja me Shpukthin (i cili nuk është më shumë se një lagje e Luznisë), në jug me Topojanin dhe në perëndim me Gjurrasin. Këto fshatra hyjnë në një ndarje më të madhe, në zonën e Grykës së Vogël.

Me mënyrën e shprehjes ata kanë vënë në lojë qeveritarë e nëpunës të fryrë dhe njerëz të tjerë me vese, të cilët nuk e kanë kuptuar domethënien e fjalës së folësit, por atë e ka kuptuar mirë dëgjuesi i tij bashkëvendës. Deri tani, për këtë lloj ligjërimi është mbledhur e shkruar me dashuri një lëndë e pasur nga Anton Çeta në kuadrin e prozës popullore të Drenicës, duke qëmtuar ato më të rëndësishmet; nga Hazis Ndreu që ka mbledhur mjaltin e kësaj të folure nga burrat e urtë të Dibrës së Poshtme; nga studimet e qëlluara të gjuhëtarit Gj. Shkurtaç; nga Mehmet Halimi etj. Të gjitha këto janë një ndihmesë e vyer si

për studiuesit sociolinguistë, ashtu edhe për popullin e gjerë.

Ky lloj të foluri ka lindur apo është krijuar prej pak njerëzve. Atyre ua kërkonte nevoja jetësore, arsyet familjare a shoqërore për t'u marrë vesh doemos me njëri-tjetrin për të dalë prej rrezikut në një moment të vështirë. Po me këtë mënyrë të foluri dërgoheshin mesazhe kushtrimi e besatimi, kur dihet se fshatrat janë larg. Ja një shembull i shkurtër: Dërgohet një lajmëtar, nga krerët malësorë, të njoftojë një nga krerët e tjerë për një ngjarje – “Thuaj filanit se në Dri janë mbytur disa lugjetën (nga: një lugat). Po shumë lugjetën u ngjitën në mal. Ti priti te Gjuri i Kuç (Guri i Kuq) dhe trembi të kthehen teposhtë. Se skifterin (lajmëtarin) e mbajta këtu”. Në këtë njoftim nuk merret vesh ndonjë gjë e veçantë, por dëgjuesi, të cilit iu drejtuan këto fjalë, e kuptoi se ushtarët armiq, në përpjekje për t'u rënë pas shpine forcave shqiptare, janë munduar të kalojnë Drinin e disa prej tyre janë mbytur. Të tjerët janë nisur të vijnë drejt teje. Ti zëru pritë dhe sulmoi që të kthehen poshtë, ku unë jam krah teje dhe ne të tjerët i presim në pritën tonë. Është e qartë se mesazhi është marrë, ndonëse është transmetuar në mënyrë të tërthortë e me nëntekst.

Kështu shtytja e parë për këtë lloj të foluri duhet kërkuar në “meseletë” që tregoheshin në kuvendet (në popull ato thirren “xhelis” apo “mexhlis”, në Dibër të Madhe thirren “mexhelis”), që zhvilloheshin, zakonisht, në odat e malësorëve. Ato u nxitën më tej, më shumë se kurrë, sidomos gjatë shekullit XIX, kur kryengritjet kundër pushtuesve ishin të shpeshta: dy herë në vit apo vit për vit. Tradicionalisht, odat kanë qenë epiqendra e lajmeve më të fundit, të bisedave të rëndësishme, të lidhjeve të pakteve, gjetja e zgjidhjeve të problemeve, që nga ato politike e deri tek ato etike. Kjo vërteton atë se “Oda e burrave” si në Kosovë e Dibër etj., ka vepruar si një institucion shoqëror, ku janë bërë pleqërime e diskutime të shumta për të gjitha problemet dhe shqetësimet e mëdha të popullit. Ishte pikërisht kjo odë e burrave, ky vend i tubimit familjar e shoqëror, që mbante gjallë, i ruante, i shtonte, i pasuronte dhe i përsoste përherë thëniet e fjalët diturake, gjykimet dhe vlerësimet e mençura tradicionale të burrave më të ditur të malësive tona”.⁴

Të folurit alegorik në Dibër është njëra nga veçoritë linguistike

dalluese të krahinës që e dallon nga trevat fqinje. Themi kështu se ky lloj të foluri në Dibër ka veçori leksikore, nëse e shohim edhe në pikëpamje fjalori a fondi leksikor. Ky fond gjen një bazë të fuqishme burimi e mbështetjeje në një numër jo të pakët fshatrash. Ato ndërtohen me një stil të veçantë e të figurshëm të gjuhës popullore. Ja si shprehen disa pleq të urtë malësorë: “Llaf me njeni-qetrin bajshim pa teklif se kush nuk bahi hafije për kurgja, se në Shqipni sundonte shqipja. Ene me ngatërrue noj shtarjakeç i pritshin llapën” (Muhabet me njeri-tjetrin bënin pa ndrojtje, se askush nuk bëhej spiun për asgjë, se në Shqipëri sundonte shqipja. Edhe po të donte të na ngatërronte ndonjë zemërlig, ngatërrestar, i prisnim gjuhën); ose “Mas xhith atij rrënajmi u deshën shumë vjet me ra disi përmendsh ki ven. Por ma, tash e mprapa, menja duhet të kishte men (Pas gjithë atij rrënimi u deshën shumë vjet për të ndërtuar vendin. Por, tani e tutje mendja duhet të kishte mend).⁵

Kjo mënyrë të foluri njihet prej shekujsh në odat dibrane, që në të vërtetë janë “shkolla”, ku mësojnë të rinjtë dibranë dhe del si një prirje e natyrshme e një mase njerëzish, klasash dhe shtresash të ndryshme, që diku më shumë e diku më pak, paraqesin zgjuarsinë e tyre natyrore (falë edhe përvojës jetësore të fituar), si dhe shpirtin krijues e prej artisti dhe nuk ka asnjë lidhje me zhargonet që i shërbejnë një shtrese të ngushtë shoqërore e që shpesh përdoren me kuptime pejorative negative.

Në këto muhabete, shpesh herë është lehtë për të hyrë, por është e vështirë të dalësh, sepse të vjen ndonjë mesele, që s’di nga t’ia mbash.

Kur flasin me shifër, zakonisht folësi, (edhe kur i krijojnë vetë për të dalë nga ndonjë situatë e vështirë) nuk thonë emrin e tyre, por se i ka thënë dikur filani (me emër e mbiemër të një burri të shquar për zgjuarsi). Realisht ajo është vlerësuar gati si një gjuhë e dytë, e cila ka pasur rrezatim jo të vogël edhe nëpër zona të tjera të Dibrës.

Kur i zoti i shtëpisë e kupton se miku i ardhur nuk di ose nuk do t’i përgjigjet, tregon një mesele të shkurtër. Zakonisht përdoret një mesele e tillë: dy vetë zihen, bjer njëri e bjer tjetri, bjer njëri e bjer tjetri. Më në fund njëri nga ata që po ziheshin i thotë

tjetrit: Bjer edhe një herë, por do ta shohësh kush jam unë. Ai i ra dhe ai që foli u palos.

Ndërsa në rrotullat ka art të fjalës, në të folurit e fshehtë ka kod apo gjuhë “të koduar” për të përjashtuar nga të kuptuarit ata që nuk bëjnë pjesë në grupin shoqëror përkatës. Të tjerët nuk e kuptonin domethënien, sepse nuk e zbërthenin dot kodin që përmbante kjo e folur.

Fjala kyç apo kodi nuk është i njëjtë, ai ndryshon sipas kohës së përdorimit dhe problemit që shtrohet. Mprehtësia ka të bëjë me atë se sa është në gjendje bashkëbiseduesi ta kapë vetë kodin apo shifrën me të cilën i drejtohen. Kështu tregohet se larg qytetit, thellë diku në një fshat, kish ardhur një njeri nga një dikaster. Njerëzit e shtëpisë e presin mirë dhe lajmërojnë, sikurse është zakon, edhe 7-8 fqinj, që të vijnë e të bisedojnë me mikun e tyre.

Për çdo pyetje që i bëhej, miku përgjigjej me: “mirë”.

- Ç’ka ndonjë të re asaj Tirane?

- Mirë.

- Po ata të naltit, ç’thonë?

- Mirë.

Pra e gjithë biseda e tij përmbledhej në fjalën “mirë”. Fqinjët që kishin ardhur, u mërzitën dhe menduan ta nxisin të zotin e shtëpisë se, mbase ky ia dinte telat, që i ardhuri të fliste. Për këtë, njeri nga ata i tha: “O i zoti i shtëpisë. Ne këtu ku jemi ulur, kemi të ftohtë (Ndërkaq zjarri në vatër bubullonte e të digjte), prandaj “shtjeri ndonji kërcu atij zjarrmi, që të nxehet ene miku!”. Miku, që s’e nuhati fare alegorinë e tyre, tha: “Jo, jo. Është shumë nxehtë”.

Është e qartë se komshinjtë nuk kishin ardhur për t’u ngrohur, por për të biseduar. Kodi që duhej kapur qëndronte në faktin se si do të zbërtheheshin fjalët që kishin të bënë me zjarrin. Në qoftë se nuk kapej kodi, që në këtë rast ishte fjala **zjarr**, gjithë biseda dhe nënteksti që përmbante ajo, do të kalonte në naivitet. Kjo kuptohet kur nëpunësi i panjohur thotë: “Jo, jo, mos e shto zjarrin, se është shumë ngrohtë”.

2.

Është fakt i pamohueshëm se ky lloj të foluri, vërtet nisi me mesele

të shkurtër, por më vonë ato kanë ardhur duke u zgjatur, pasi njerëzit kanë vrarë mendjen dhe i kanë bërë "meseletë" e tyre më të stërholluara. Po kush ka qenë i pari që i "zhvilloi" ato? Asnjëri nuk përgjigjet, sepse, sikurse u përmend, ky lloj të foluri ka filluar të praktikohet e të ushtrohet disa breza përpara. Të folurit alegorik, që realizohet me mesele, përbëhet nga fjalë që i përshtaten ngjarjes, se ndryshe fjalët nuk kanë asnjë kuptim. Nga të moshuar dibranë është thënë e thuhet se ky i folur, që përdoret edhe në disa treva të tjera, ka lindur në malet e Dibrës. Madje janë rrethanat ato që të detyrojnë të flasësh, duke fshehur mendimin tënd.

Tregojnë se në kohën e pushtimit serb, një hafije spiunon se filani një pushkë e një nagant s'i ka dorëzue. Shkon komandanti me ushtarët dhe i kërkon të zotit të shtëpisë t'i dorëzojë armët. Ai përgjigjet se s'ka armë. Oficeri i thotë se e dimë që i ke dhe janë në filan vend. Ai hap vendin dhe aty gjejnë vetëm pushkën. Nagantin burri e kish pasur në brez. Oficeri mendon se hafija e pati shtuar vetë edhe një nagant.

Kur dalin në oborr, aty ishin mbledhur fshatarë, që donin të dinin si shkoi puna e donin ta pyesnin, por aty ishin ende pushtuesit. Njëri prej tyre e pyet me sy. Fshatari iu përgjigj: Buça cofi, po klyshin e kam xhallë (gjallë); (pushkën ma morën, por patllaken e kam).

Për të treguar kujdesin dhe rëndësinë që i është dhënë këtij të foluri, bëhet edhe një krahasim i tillë: Kur ka shtënë me pushkë malësori e luftëtari e ka shkrepur shpejt armën, por, kur ka bërë llaf (muhabet) me mesele e ka bluar mirë me veten, që fjala e tij të mos shkojë dëm, se edhe vetë vlera e folësit bie, madje edhe humbet. Po të marrësh pjesë në tubimet e malësorëve (dasma, mort etj.), biseda zhvillohet ngadalë, fjalët thuhën shkoqur, me një farë pauze midis tyre. Madje ndodh që fjala i drejtohet dikujt, zakonisht ndonjë burri të ri në moshë, në formën e një pyetjeje. Burri, po e diti i përgjigjet, po s'që në gjendje, asnjëri s'ia merr për keq, kur dihet se pyetja nuk ishte për të, e thotë dhe kërkon me sy nëpër dhomë. Në atë kohë, ai të cilit i drejtohet realisht pyetja, kërkon fjalën. Fjalët janë trashëguar prej të parëve dhe kanë kaluar nga brezi në brez jo si salltanet apo zbukurim, por si një send, mjet, diamant i çmueshëm. Ky diamant u ka

shërbyer njerëzve për të “mprehur” mendjen, që ato dy fjalë a shprehje të figurshme të mbaheshin mend, të kalonin nga mexhelisi në odat e tjera e të përdoreshin në Kuvendet e Dheut apo në Kuvendet e Besëlidhjeve kundër armikut, ku merrte pjesë i gjithë populli. Zakonisht, në këto kuvende thirreshin burra mendtarë nga të Nëntë Malet e Dibrës (që emërtoheshin kështu: Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri e Luznia në Dibër të Poshtme dhe Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza e Katër Grykët në Dibër të Epërme, zona që përfaqësojnë edhe male, ashtu si thotë edhe populli “male me halle”, pra me domethënien për trimëri, si dhe të zgjedhura e të caktuara edhe për zgjuarsi, por veçanërisht për prijës të njohur, krerë të krahinës e ish-luftëtarë trima). Në “Kuvendet e Dheut” paraqiteshin mosmarrëveshje të ndryshme dhe, në to, asnjëherë nuk jepej mendimi i drejtpërdrejtë, por duke treguar një “mesele”, të cilën të dy palët e kuptonin se kush kishte të drejtë. Madje mund të tregoheshin edhe dy a më shumë “mesele”. Natyrshëm shtrohet pyetja: A kishte drejtësi në këto Kuvende të Dheut? Sigurisht që po. Duhet shënuar se një pjesë e kuvendarëve dhe burrave të mençur nuk ishin të pasur, nuk kishin shumë toka e tufa të mëdha me bagëti dhe hambarët e drithit nuk i kishin gjithnjë plot, por mbaheshin me mundin e djersën e vet. Në rast se do të kishte “hatëre” (anësira) atëherë ata do t’i përfliste gjithkush, nuk do t’i përfillte askush dhe, për gjithë jetën, në sytë e popullit, do të ishin mashtrues. E të jesh mashtrues në Dibër është e rëndë, jo vetëm për vetë njeriun, por edhe për familjen e tij, madje edhe për tërë fisin. Puna shkonte deri atje sa njerëzit nuk do të kishin besim as të jepnin vajza për nuse e as të merrnin nuse vajzat e tyre. Kështu që asnjëri nuk guxonte të jepte mit, as ta merrte atë.

Zakoni i mitmarrjes në ato kohëra, në këtë trevë, duke qenë i papranueshëm, nuk njihej. “Parimi kryesor i çdo pleqnari (kur zgjidhet njeri si kryetar – A.K.), ishte ta zgjidhë çështjen në mënyrë sa më të drejtë, që të mos dëmtohej kush pa pasur faj. Njëkohësisht, pleqnarët e ndërgegjshëm, janë munduar t’i zbusnin konfliktet, kur ka qenë e mundur...Jo me i lanë hasëm, po me i lanë vllazën”.⁶ Në Dibër, është rregull që, kur pleq nga të dy anët shkojnë të ndajnë mosmarrëveshje, ngatërresa etj., marrin me vete ndihmës, që quhen çekiç, në rolin e këshilluesit,

të cilët plotësojnë, kur e shohin që është e nevojshme. I thonë çekiç, se ata e ndjekin mirë muhabetin dhe janë në pritje gati, që të “godasin” (flasin) si çekiçë për ta bindur “kundërshtarin” në drejtësinë dhe pamundësinë e një zgjidhjeje tjetër.

Ky komunikim varej nga kushtet shoqërore e politike, ku individit i duhej ta përballonte gjendjen me vështirësi, prandaj ai bënte “ftesë” për bashkëpunim e mbështetje e kjo bëhej më mirë me gjuhën e “fshehur”. Në këtë aspekt, kjo gjuhë është vepruese, sepse, sikurse thuhet me të drejtë, “sociolinguistika ka për detyrë të zbulojë normat e komunikimit shoqëror dhe t’i përqsasë e t’i ballafaqojë ato me normat e sistemit shoqëror, duke na bërë të ndërgegjeshëm për masën në të cilën shmangiet nga një variantet i kanë shkaqet në sistemin shoqëror dhe në sjelljen gjuhësore të individëve”. Bashkëpunimi e komunikimi shoqëror ishte vendosur e forcuar dita-ditës, kur në horizont shfaqeshin ushtritë armike. Jepej kushtimi dhe të gjithë ishin në këmbë. Disa herë, për probleme atdhetare e jetësore mblidhej kuvendi. Për ngjarje atdhetare mblidhej gjithë populli dhe secili kishte të drejtën e fjalës. Për mosmarrëveshje personale mblidhej një këshill i vogël i zgjedhur nga palët në konflikt.

Përpara se të mblidhej këshilli i burrave, veçanërisht,⁷ të zgjuar (ku bënin pjesë zakonisht burrat më të moshuar, të thirrur, shpesh, edhe nga ana e anës), ishte organizuar puna dhe ishte caktuar data dhe vendi, ku do të mblidheshin. Aty asnjëri nuk ngutej për të folur. Palët që kishin mosmarrëveshje, pasi jepnin shpjegimet e veta, hiqeshin mënjanë për t’i lënë të qetë burrat e zgjedhur. Ata mendoheshin, por edhe këshilloheshin. Fjalën e merrte më i vjetri, i cili bënte një përshkrim të shkurtër të ngjarjes a mosmarrëveshjes. Kjo fjalë e tij tregonte se kuvendi ishte hapur... Me këtë maturi është bërë e mundur që në vitet e vështira të pushtimeve, burrat mentarë t’i drejtojnë malësorët, t’i ruajnë zakonet e vendit, të ruajnë vëllazërimin, identitetin e trojet e veta. Karakteristikë është se ky lloj të foluri ka në mes një “shifër”, që është ai kod i fshehtë të cilin, me intuitë, e kuptojnë vetëm ata që marrin pjesë në bisedë. Një gjë e tillë ndodh edhe për arsye se ata kanë dëgjuar shumë mesele dhe, kësisoj, janë në gjendje të sjellin në mend atë më të përshtatshmen ose të “sajojnë” ndonjë të përafërt.

Duhet shënuar edhe një fakt tjetër që është një veçori dalluese për të folurit alegorik ose me “shifër” apo për këto “rrotulla”.. Kjo gjuhë përdorej me qëllimin e mirë për të gjetur shkaku dhe pasojën, që të zgjidhej drejt ankesa, të mos kishte mosmarrëveshje që do të nxisnin gjakmarrjen, e cila do të shuante shumë jetë njerëzish. Nuk është e panjohur një zgjidhje mosmarrëveshje, ku u fol me shifër. Thuhet se një vajzë e fejuar që në djep, kur u rrit, ra në dashuri me një djalë tjetër. Vajza nuk desh të martohej se ajo ishte shtatzënë me djalin që dashuronte. Megjithëkëtë, asnjëra palë nuk u tërhoq dhe martesë u krye. Dhëndëri vërtetoi se ajo nuk ishte e virgjër dhe, madje, ishte edhe shtatzënë. Sipas zakonit familja e djalit e vrau nusen e “pandershme”. Familja e vajzës nuk kërkonte gjakmarrje për të bijën e shturur. Këtë e kërkoi familja e djalit të dashuruar me vajzën. Ata kërkonin nipin ose mbesën e tyre, që u vra bashkë me të ëmën. Puna shkoi keq dhe gjakmarrja ishte gati për të filluar. Atëherë njerëzit e dhëndrit thirrën në kuvend njerëzit e djalit të dashuruar me vajzën. Secila anë zgjodhi dhe thirri të mençurit që mund t’i përfaqësonin dhe që do ta zgjidhnin çështjen me drejtësi. Këtu kemi dy grupe burrash pleq, që do të ndanin mosmarrëveshjen duke i dhënë të drejtë njëres palë. “Pse ma grise thesin”, pyetën pleqtë nga ana e djalit të dashuruar me vajzën. “Po ti, pse fut miell në thes të huaj”, iu përgjigjën nga ana e dhëndrit. Me këtë përgjigje të bukur e të mençur u mbyll grindja midis dy fisesh.

Ata, që e kanë sajuar këtë lloj të foluri, kanë synuar që përmes tyre të ruhen e të kultivohen ato virtyte të mira që ka populli dhe i trashëgon në breza, siç janë: nderi, besa, burrëria, shpirti liridashës, atdhedashuria e madhe, urrejtja për pushtuesit e ndryshëm. Në to i thuren himne shpirtit të qëndresës, guximit, papërkulshmërisë ndaj dhunës e masakrave të armiqve dhe vlerësohet e lartësohet gatishmëria që, për trojet e të parëve, për çdo pëllëmbë të tokës shqiptare dhe për lirinë e atdheut, të derdhnin gjakun. “Mënyra e të përdorurit të alegorisë është shumë e larmishme. Zakonisht, kur janë vetëm dy vetë, nuk flasin me alegori. Por kjo nuk është e prerë. Ka raste që, edhe kur ndodhen vetëm dy vetë, ata nuk i flasin drejtpërdrejt njëri-tjetrit, p.sh., kur njëri do t’i thotë tjetrit ndonjë llaf të rëndësishëm ose të tij, ose të porositur prej dikujt, ose kur njëri kërkon t’i lypë

ndonjë send të vlefshëm tjetrit dhe, ngase i vjen zor, ia nis kërkesën me mesele, larg e larg. Po kjo bëhet më shumë për t'i dhënë rëndësi të veçantë muhabetit.”⁸

Shpesh njerëzit duan të dëgjojnë mesele me të folur me shifër dhe, kur në shtëpi, në rreth miqësor u vjen ndonjë njeri që dihet se është i zgjuar apo ndonjë që di shumë mesele me shifër, përpiqen ta ngacmojnë që të dëgjojnë se si do të përgjigjet. Tregojnë se në një familje vjen një mik i tillë dhe, për ta nderuar, ata therin një berr. Kur vjen koha e darkës, sigurisht që koka i vihet përpara mikut. Ai e hapi kokën dhe e pa se ishte pa tru. Të gjithë prisnin se si do të vepronte: a do të bërtiste se po talleshin me të apo do të zgjidhte ndryshe. Miku tha: “O i zoti i shtëpisë! Unë e di që njerëzit e këtij katundi janë pa tru, por që edhe gjëja e gjallë këtu qenka pa tru, tani e mora vesh”.

Mënyra e përdorimit të alegorisë, në të shumtën e rasteve, nuk është e njëjtë, sepse edhe mosmarrëveshjet e zgjidhjet e tyre nuk janë të njëjta. Kjo ka bërë që ky lloj të foluri të jetë i pasur si në sasi, ashtu edhe në cilësinë e tij.

Alegoria dibrane përbëhet nga veçori të shquara stilistike e figurative në nëndialektin vendor lokal, ku përdoren, ndofta pa ndonjë përjashtim, edhe elemente lokale, si: Korabi (mal) me borë ose bora atje ka shkrire, Drini (lum) me ujë të turbulluar a të kthjellët, për barinj që dinë ta mbledhin bagëtinë apo që ajo i ikën, lugetër, etj. Në ato tregime shihet se kemi një përdorim të përsosur të gjuhës dhe paraqitjes së të folurit, ku dallohet stili i pasur me figura letrare artistike e veçanërisht me alegori, metonimi, simbole etj., sikurse janë shprehjet e shënuara më lart, si: mendja duhet të kishte mend; jo me i lanë hasëm, po më i lanë vllazën, lugetërit, mielli etj.

Në qoftë se marrim sistemin fonetik, rotacizmi është një dukuri që ka ndodhur në dialektin e toskërishtes, gegërishtja ka ruajtur bashkëtingëlloren n ndërmjet zanoreve, p.sh.: rëra-rana, bëra-bana, lakra-lakna, dimri-dimni. Zanoret hundore janë karakteristike për gegërishten, ndërsa në toskërishte kemi vetëm zanore gojore, si p.sh.: zani-zëri, huni-huri.

Në dialektin e veriut:

- grupet e bashkëtingëlloreve **mb. nd** shqiptohen me reduktim të tyre, si p.sh.: mbante – mante, ndal – nal, ndonjë – noj;

- kthimi i r në n, shprehet në nazalizimin e fjalëve, të tilla si: mprehur – mprehun, mbajtur – mbajtun, përshtatur – përshtatun;
- kthimi i y në i: dy – di, atyre – atine, emra – emna;
- janë të zakonshme kthimet e zanores së hapur i në aj, si: shtëpi-shtëpaj, fill-fajll;
- nazalizimi i lidhëses bashkërenditëse **edhe** në formën e shkurtuar me n, si p.sh.: edhe – ene etj.
- Në të folurin e toskërishtes kemi gjithmonë togun zanor **ua**, në gegërishte përdoret togu **ue**, që shkon deri në thjeshtimin e tij në u, p.sh.: grua-grue-gru; duar-duer-dur; kërkuar-kërkue-kërku, filluar-fillue-fillu, mësuar-mësue-msu etj,;
- të pakryerën e foljeve veprorë gegërishtja e formon duke i paravenë pjesëzën përemërore **u**, që del e qartë në format: u rritsha, u lajsa, etj.
- “Në të folmen e Dibrës, zanorja **a** i ka karakteristikat kryesore si e ngritjes së ulët, e rradhës së prapme, e palabializuar dhe del vetëm si zanore gojore.
- Koha e ardhshme e foljes në dibranishte bën në mënyrë specifike.
- Kështu fjalëzat – do të – janë shkrirë dhe kanë formuar fjalëzën – tët, pra edhe në këtë të folur e ardhmja bën me fjalëzat – do të – dhe të tashmen”.⁹
- Në dallimet e tjera morfologjike, veçohet ajo e strukturës së veçantë të paskajores së gegërishtes që vjen në formën e njohur të tipit **me + pjesore**: me dalë, me shkue, me shtaj, me punua, me këndue, etj.
- ndërsa ndihmësja **duke** bën **tue**: tue ftollue, tue zgjatun, tue mbajt, etj.

3.

Thelbi i të folurit alegorik, apo si i thonë dendur në Dibër me “shifër”, duhet parë në disa rrafshë, nga të cilat, mbase, më të rëndësishëm janë:

Për të zgjidhur me fisnikëri dhe me mirëkuptim problemet e shumta sociale, ata kanë mprehur gjuhën dhe, përmes saj, mënyrën e të folurit. Kjo ka ardhur edhe si nevojë për t’u kuptuar mes tyre, mes atyre që ishin në pozitën e prijësve popullorë, por

edhe për të mos u marrë vesh nga pushtuesit e huaj. Nga treguesit e të folurit me "shifër" me të drejtë është përmendur: "Atine ua kish kërkue nevoja, halli me u marrë vesh domosdo me njani-qetrin, në një "dekik" të vështirë, për me dalë prej rrezikut". Çdo lidhje, çdo qëndresë, çdo konflikt mund të bëhej e të zgjidhej në sy të kujtdo dhe dëgjuesit jodibranë, madje edhe të fshatrave e zonave ku nuk flitet kështu, të mos ishin në dijeni të marrëveshjeve që realizoheshin. Kjo ka qenë edhe një "pasaportë" e mençurisë personale, por edhe të fshatit të lindjes, që e dallonte folësin për burrinë dhe karakterin e paepur, sepse kjo ndërmarrje me këta malësorë, kishte gjithnjë të nënkuptuar e përmbante brenda saj fjalën e thukshme "besë".

Fjalori i tyre është i kursyer, i zgjedhur, me ngjyresa artistike. Me përdorimin e fjalëve dialektore dhe krahinorizmave, jo vetëm që synohej të qëllohej drejt e në shenjë, por "fshihej" edhe çelësi që i hapte ato, sepse fjalët ishin të gjalla, plot vlagë, se mendja e tyre çmohej nga populli si "tel" dhe zgjidhjet ishin aq të shkëlqyeshme, ashtu siç janë edhe perlat.

Për këtë arsye, me të drejtë është vërejtur se karakteristikë themelore e shprehjes me nënkuptime është shprehja e shkurtër, me pak fjalë, me stil të gdhendur, si pasojë e një mendimi që del si fryt i gjakftohtësisë, i marrjes me maturi të vendimeve, i matjes për kohën dhe vendin e përshtatshëm dhe peshës së fjalës. Nëpërmjet nënteksteve të mprehta apo me anën e "meseleve", "rrotullave" apo "shifrës", të folurit është bërë i figurshëm dhe, si i tillë, është kthyer nga një mjet i zakonshëm kumtimi, në një mjet arti me fuqi të madhe. Karakteri artistik i tyre është natyrë popullore dhe, njëkohësisht, ka marrë forcë nga shpirti i tij krijues. Mbase mjaftojnë vetëm këto pak fjalë për t'u bindur për figuracionin e pasur që ka kjo e folur: në këto *vala (luftë)*, të mos pushonte *gjoja e dajlanes (goja e pushkës)*, me *mprehun llafin (mprehur fjalën)* etj. Kjo është edhe një nga dëshmitë e tjera se gjuha jonë ka një gjallëri të madhe, me gjerësi dhe larmi fjalësh dhe kuptimesh, me frazeologjizma të pasura, ku ravijëzohet dukshëm ngjyresa emocionale, që përmban në esencën e saj. Është kjo një nga arsyet që shprehjet popullore me ngjyresa figurative e mjete të tjera stilistike e letrare i ndesh kudo në trevat shqiptare, ashtu edhe në trojet e tjera jashtë kufijve apo edhe

në diasporë. "Në Drenicë e gjetkë është zakon që, pasi largohen mysafirët, fqinjët dhe të njohurit e tjerë pyesin njerëzit e shtëpisë: "A jua paguan odën apo jo?", d.m.th., a ishin burra të mençur dhe a lanë ndonjë fjalë të urtë, ndonjë rrotull që vyen, që e pasuron traditën e mirë të vendit. Kur përgjigja është: "Na e paguan dhe na e tepruan", do të thotë se oda ka pasur burra mendëtarë e të ditur dhe i zoti i shtëpisë e të tjerët kanë mbetur të kënaqur".¹⁰

Kështu, nëpërmjet të folurit alegorik plotësohet, së fundi, edhe "Një kërkesë e rëndësishme e kuptimit të shprehimësisë, që fjalitë që mos kenë gjymtyrë të tepërta, të panevojshme. Me këtë kuptim, flasim për lakonizmin, shkurtësinë. Mënjanoni shprehjet parazite, përsëritjet e kota, që e lodhin dëgjuesin dhe ulin interesimin e tij.

Kur duam ta bëjmë rrëfimin e gjallë ose të japim shpejtësinë e veprimeve, përdorim kohën e tashme të dëftores (e tashmja historike), ndonëse veprimet i takojnë së shkuarës dhe duhej të përdornin kohët e shkuara".¹¹

Edhe dukuritë e veçanta sociolinguistike janë shprehje e jetës dinamike të popullit, sepse janë elementë të kultivuar me përkujdesje, respekt e dashuri prej tij, të cilat koha nuk i ka bjerrë, por i ka pasuruar, duke dëshmuar edhe identitetin tonë kombëtar.

Literatura e shfrytëzuar:

¹ Gjovalin Shkurtaj, Sociolinguistika, Tiranë, 2003, fq. 43

² Anton Çeta: "Prozë popullore nga Drenica" I, Prishtinë, 1972. f.12.

³ Haziz Ndreu, Rreth të folurit alegorik në Dibër, në "Dibra dhe dibranët", kumtues nr. 1, Peshkopi, 1981, f.79,80.

⁴ Gjovalin Shkurtaj, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe, Tiranë, 2003, fq. 225.

⁵ Kumtesë e cit.H. Ndreu: Rreth etj.

⁶ A. Çeta, vep. e cit. f. 28.

⁷ Vep. e cituar, Gj. Shkurtaj: Socio., f. 48.

⁸ A.Ndreu: Kumtesë f. 80

⁹ Zeqir Kadriu: "Dialektet dhe të folurit e shqiptarëve në Maqedoni". Tetovë, 2002, f. 57-58.

¹⁰ Vep. e cit..Gj. Shkurtaj: Kahe etj.

¹¹ E. Hysa, Gj. Shkurtaj etj: 'Gjuha shqipe 1 " për shkollat e mesme. Tiranë, 2003".